

Udhëzime për përdorim

NWZ-A15/A17



Mbi manualët

Për të shikuar informacione të hollësishme mbi WALKMAN®, shkoni në ueb faqen dhe merrni Help Guide nga interneti.

http://rd1.sony.net/help/dmp/nwza10/h_ww/

Ndonëse shfletimi i faqeve mund të jetë falas, mund të kërkohej pagesë për disa aktivitete varësisht nga kontrata e operatorit tuaj.

Në lidhje me përdorimet themelore, ueb faqja e mbështetjes së konsumatorit dhe informacione të rëndësishme, shikoni “Si të instaloni dhe lexoni Help Guide” seksionin në këtë manual.



* 4 5 4 0 3 0 5 1 2 * (1)

Përmbajtja

Ju lutemi kontrolloni pjesët në paketimin.

Walkman (1)


USB kordon (1)

Udhëzime për përdorim (ky manual)

Kufjet dhe microSD karta nuk jepen me pajisjen Walkman.

Karrikimi i baterisë

Bateria e Walkman-it tuaj karrikohej kur pajisja është e lidhur me kompjuter të kyçur.



Kur Walkman-i juaj është karrikuar plot, largojeni nga kompjuteri.

Shënime

- Për të parandaluar prishjen e baterisë, karrikojeni së paku njëherë në çdo gjashtë muaj

Si të instaloni dhe lexoni Help Guide

Instaloni “Help Guide” në kompjuterin tuaj. Në këtë gjenden përdorime themelore të pajisjes dhe ueb faqen për mbështetje konsumatori për të transferuar përmbajtje si muzikë në Walkman-in tuaj.

1 Lidheni Walkman-in ruaj me kompjuter të kyçur.


2 Hapeni dosjen vijuese dhe klikoni dy herë në skedarin ekzekutiv të Walkman.

- Windows 7 ose më të vjetër: [Start] – [Computer] – [WALKMAN] – [FOR_WINDOWS] – [Help_Guide_Installer(.exe)].
- Windows 8: [Start screen] – [Desktop] – [File Explorer] – [Computer] – [WALKMAN] – [FOR_WINDOWS] – [Help_Guide_Installer(.exe)].
- Windows 8.1: [Desktop] – [File Explorer] – [This PC] – [WALKMAN] – [FOR_WINDOWS] – [Help_Guide_Installer (.exe)].
- Mac: [Finder] – [WALKMAN] – [FOR_MAC] – [Help_Guide_Installer_for_mac].

3 Ndiqni udhëzimet në ekran.

4 Për të lexuar Help Guide, klikoni dy herë në ikonën ose ikonën alias që është krijuar në kompjuterin tuaj.

Si të përdorni Walkman-in tuaj



Kyçja dhe shkyçja e pajisjes

Kyçja e pajisjes

Rrëshqitni HOLD kyçësen në drejtim të kundërt të shigjetave dhe shtypni ndonjë buton.

Zgjedhja e gjuhës së ekranit

Zgjidhni gjuhën e ekranit para transferimit të përmbajtjes.

1 Nga Home, menyja, zgjidhni **[Settings]**.

2 Zgjidh **[Language Settings]** – gjuhën e preferuar.

Shkyçja e pajisjes

Shtyp dhe mbaj OPTION/PWR OFF butonin.



⚠️ Këshillë

- Nëse nuk përdoret, ekrani do të shkyçet. Për të kyçur ekranin, shtypni BACK/HOME butonin.
- Nëse nuk përdoret për një kohë të gjatë, Walkman-i juaj do të shkyçet automatikisht.

Si të përdorni Home Menynë


Menyja Home paraqitet kur të shtypni dhe mbani BACK/HOME butonin. Menyja Home është pika e nisjes për të dëgjuar zërin, kërkuar këngë, ndryshuar rregullimet, etj.

Nga menyja Home mund të zgjidhni opsionin e preferuar në ekran duke përdorur butonin me 5 drejtime.




Menytë dhe ilustrimet e treguara në figurë janë vetëm për referencë dhe mund të dallojnë nga menytë e produktit të vërtetë.

Pjesët dhe kontrollat



1 BACK/HOME butoni

2 Butoni me 5 drejtime ¹



3 Kyçësja për kufjet

4 WM-PORT kyçësja

Lidhni USB kordonin (e dhënë) ose pajisje periferike (nuk jepen).

5 Ekrani

6 VOL (Volume) +*/- butoni

Shtypni VOL + butonin për të rritur dhe VOL – butonin për të ulur nivelin e zërit.

7 OPTION/PWR OFF (Option/Power off) butoni

Shtyp për të shfaqur menynë me opsione.

Nëse shtyp dhe mban këtë buton, ekrani do të shkyçet dhe Walkman-i juaj kalon në modin standby.

8 HOLD kyçësja

9 Llamba qasëse

10 Vendi për microSD kartë

Vendosni microSD kartën deri kur të klikojë në vend.

11 Kapaku i vendit

12 Vrima për rripin

13 Antenë Bluetooth të integruar

14 N-mark

15 RESET butoni

Përdorni laps ose kapëse për letër, etj.

^{*1} Kanë pika prekesë. Përdorni për të ndihmuar me përdorimin e butonave.

Mbi rregullimin e zërit (Vetëm për vendet/rajonet që zbatojnë Direktivat Evropiane)

Një alarm (sinjal) dhe shenja "Kontrolloni nivelin e zërit" shërbejnë për të mbrojtur veshët tuaj gjatë rritjes së nivelit të zërit mbi një nivel të caktuar*1 për herën e parë.

Mund të anuloni alarmin dhe paralajmërimin duke shtypur ndonjë buton.

Shënime

- Mund të rritni nivelin e zërit mi nivelin specifik*1 pas anulimit të alarmit dhe paralajmërimin.
- Pas paralajmërimin fillestar, alarmi dhe paralajmërimin përsëriten çdo 20 orë kumulative që niveli i zëri është vendosur mbi nivelin specifik*1; kur kjo ndodh, zëri ndryshohet ne nivelin [7] automatikisht.
- Nëse zëri është vendosur mbi nivelin specifik dhe shkyçeni Walkman-in, niveli i zëri kthehet në nivelin specifik automatikisht.


Mënjanimi i problemeve

Nëse Walkman-i juaj nuk funksionon mirë, provoni hapat më poshtë për të zgjedhur çështjen.

1 Gjeni simptomat e çështjes në "Mënjanimin e problemeve" në Help Guide (HTML dokument) dhe provoni ndonjërin prej veprimeve më poshtë.

2 Lidhni Walkman-in tuaj me kompjuterin për të karrikuar baterinë.

3 Shtypni RESET butonin me laps ose me kapëse për letra, etj.



Simptoma & Zgjidhja

Walkman-i juaj nuk mund të karrikojë baterinë ose nuk njihet nga kompjuteri juaj.

USB kordoni (i dhënë) nuk është lidhur me USB kyçësen e kompjuterit tuaj në mënyrë të drejtë. Largoni USB kordonin dhe lidhni sërish. Përdorni USB kordonin e dhënë.

Kur të përdorni Walkman-in tuaj për herën e parë, nëse nuk e keni përdorur Walkman-in për kohë të gjatë, mund të kalojnë disa minuta të që njihet nga kompjuteri. Kontrolloni që kompjuteri të njeh Walkman-in pasi që të keni lidhur për pas 10 minutave.

Walkman-i juaj nuk mund të përdoret ose nuk mund të shkyçet.

Nuk mund të përdorni Walkman-in tuaj kur është i lidhur me kompjuter. Largojeni nga kompjuteri.

Paralajmërim

Informacione mbi ligjet dhe shenjat dalluese

Për informacione mbi ligjet dhe shenjat dalluese, shikoni "Informacione të rëndësishme" që vijnë me softuerin e dhënë. Për të lexuar tërësisht, instaloni softuerin e dhënë në kompjuterin tuaj.

Për kufjet

- Mos lëshoni njësinë në zë të lartë sepse dëgjimi më afatgjatë me zë të lartë mund të ndikojë mbi të dëgjuarit.
- Në zë të lartë, zërat e jashtme mund mos të dëgjoen. Mos dëgjoni me njësinë në situata ku dëgjimi nuk duhet të pengohet, për shembull gjatë vozitjes ose drejtimit të biçikletës.
- Meqë kufjet e dhëna janë të dizajnit të hapur, zëri kalon nëpër kufjet. Mbani mend që mos të pengoni personave që janë afër juve

Shënim i pronarit

Modeli dhe numrat serik gjenden mbrapa aparatit. Shënoni në vendin e dhënë më poshtë. Shikoni këto numra çdoherë kur të lajmëroni Sony distributorin në lidhje me produktin.

Nr. i modelit _____

Nr. serik _____

TRA

REGISTERED No: ER34842/14

DEALER No: DA0096946/12

Dizajni dhe specifikimi mund të ndryshohen pa paralajmërim paraprak.